

MENDIM PARALEL

Unë Lulzim Hamitaj, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, që ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan – duke e mbështetur vendimmarrjen përfundimtare për shkarkimin nga detyra të këtij subjekti dhe, ndërkohë, duke ndarë qëndrim ndryshe nga ai i mbajtur nga dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues, lidhur me disa pika – në vijim po pasqyroj mendimin tim paralel/ndryshe ndaj arsytimit të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

1. Lidhur me analizimin e rrethanave në raport me kriterin e pasurisë, nuk jam dakord me konkluzionin për fshehje të pasurisë (në emër të prindërve) dhe, konkretisht, me arsyetimet dhe konkludimet në raport me pasurinë nr. 3, për sa u përket (vetëm) pikave në vijim:

3.76. *Për sa më sipër [...], Komisioni çmon se krijohen dyshime të arsyeshme se pasqyrimi i emrit të babait të subjektit në kontratën e porosisë së datës 11.12.2006, e më pas i emrit të nënës së tij në kontratën e shitjes me kusht të datës 17.12.2014, bashkë me deklarinin në deklaratën Vetting i të drejtës së banimit të tij dhe të pronësisë së nënës së tij janë veprime në funksion të fshehjes së të drejtës së pronësisë së subjektit të rivlerësimit mbi apartamentin e sipërcituar, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

3.77. *Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit se ka vetëm të drejta banimi dhe deklarimi i personit të lidhur/F. M. në deklaratën Vetting 2017 i të drejtës së pronësisë për apartamentin me sip. 112 m², me adresë lagjja “***”, Elbasan, nuk bindin për vërtetësinë e tyre dhe, për rrjedhojë, Komisioni e vlerëson sjelljen e subjektit si përpjekje për të fshehur pasurinë në emër të prindërve, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

13.2 *Lidhur me pasurinë apartament me sip. 112 m², në lagjen “***”, Elbasan, deklarimi i subjektit të rivlerësimit se ka vetëm të drejta banimi dhe deklarimi i personit të lidhur/F. M. në deklaratën Vetting 2017 i të drejtës së pronësisë për apartamentin me sip. 112 m², me adresë lagjja “***”, Elbasan, nuk bindin për vërtetësinë e tyre, por nisur nga të dhënat e pasqyruara paragrafin 3.76, si më lart, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur rrethana jo të vërteta e, për rrjedhojë, Komisioni e vlerëson sjelljen e subjektit si përpjekje për të fshehur pasurinë në emër të prindërve, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

1.1 Lidhur me konkluzionet e lartpërmendura vlerësoj se nuk është i bazuar përfundimi se subjekti ka kryer fshehje të pasurisë *de quo* për këto rrethana dhe shkaqe: (i) Në deklaratën Vetting subjekti e ka deklaruar marrjen e kredisë prej 2,5 milionë lekësh, pikërisht për blerjen e këtij apartamenti; (ii) Në deklaratën Vetting 2017, në seksionin “Vendqëndrim tjetër...”, subjekti ka deklaruar adresën lagjja “***”, rruga “***”, pallati i ***-së, kati i 3-të banim, Elbasan, pra, pikërisht apartamentin me sip. 112 m², në pronësi të nënës së tij. Gjithashtu, kjo adresë është deklaruar nga subjekti edhe në DIPP-të e viteve 2010, 2012 dhe 2016; (iii) Në përgjigje të pyetësorit standard (si edhe më pas), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga viti 2008 e në vijim ka jetuar së bashku me bashkëjetuesen dhe vajzën në apartamentin e hipotekuar në emër të nënës së tij, znj. F. M., me adresën përkatëse; (iv) Gjithashtu, në

deklaratën *Vetting*, personi i lidhur/nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. F. M., ka deklaruar: “*Pronare me certifikatë për vërtetim pronësie të një apartamenti me sip. 112 m², në lagjen “****”, Elbasan, me nr. pasurie ****, në z. k. ****, Elbasan. Pjesa takuese: 100%*”. Si burim krijimi ka deklaruar kursimet e saj dhe të bashkëshortit të ndjerë, si dhe kredinë e marrë nga djali i saj, z. Hektor Mushi. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor përkatës; (v) Në kontratën e nënshkruar nga nëna e subjektit me shoqërinë shitëse parashikohet se çmimi i shitjes prej 5.510.400 lekësh do të paguhej me dy këste: (a) kësti i parë prej 3.010.400 lekësh është likuiduar nga blerësi në datën 24.8.2009, sipas mandatarkëtimit nr. 24/8, datë 24.8.2009, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k.; (b) kësti i dytë prej 2.500.000 lekësh do të likuidohet pas disbursimit të kredisë nga ana e ****, e cila do të disbursohet në llogarinë e noteres e, më pas, do t’i transferohet shitësit.

1.2 Nisur nga sa më sipër, rezulton se kjo pasuri është deklaruar në mënyrë të përsëritur pranë ILDKPKI-së dhe Komisionit – nga subjekti si vendbanim dhe si kontribut financiar nëpërmjet kredisë bankare e, gjithashtu, edhe nga nëna e tij si një pasuri, bashkë me burimet përkatëse, duke paraqitur edhe dokumentacionin ligjor përkatës. Kësisoj, në këndvështrimin tim, ky apartament nuk mund të kualifikohet si një pasuri e fshehur, për sa kohë ekzistenca, pronësia dhe disponimi/përdorimi i tij është përshkruar saktë në deklaratimet përkatëse, periodike dhe *Vetting*, konform statusit juridiko-faktik të pasurisë në fjalë.

1.3 Lidhur me faktin se kjo pasuri do të duhej të ishte regjistruar në emër të subjektit, pasi ky i fundit (supozohet se) ka qenë investues i vetëm dhe emri i prindërve është përdorur me qëllim fshehjen e kësaj pasurie duke tentuar, kësajsoj, shmangien e verifikimit të burimit të ligjshëm, të përdorur për krijimin e saj, në vlerësimin tim, ky qëndrim është i pabazuar dhe mbetet vetëm në nivel hipoteze dyshuese, së paku, për tri shkaqe: (i) investimi i kryer nga subjekti rezulton të ketë qenë vetëm 2,5 milion lekë (nëpërmjet kredisë së deklaruar rregullisht), pra më pak se gjysma e çmimit – ndërkohë që pjesa tjetër është paguar nga anëtarët e tjerë të familjes; (ii) prindërit e subjektit ishin persona të lidhur e, rrjedhimisht, subjekte deklaruese, sikurse në fakt nëna e tij e ka deklaruar këtë pasuri (si më lart) dhe përdorimi i apartamentit *de quo* nga subjekti, i ndërthurur me marrëdhëniet financiare mes anëtarëve të familjes, gjenden në dinamikën e marrëdhënieve të posaçme, të cilat nuk bindin që të jenë kryer në funksion të shmangies së kontrollit – sikurse nuk e kanë shmangur atë dhe në ato rrethana as nuk mund ta shmangnin; (iii) pamundësia financiare e konstatuar për krijimin e kësaj pasurie, prej rreth 1,4 milionë lekësh – përpos faktit të moskonsiderimit të kontributit të vëllait të subjektit nga Gjermania, që do ta zeronte këtë mungesë (i cili ka pretenduar pamundësinë objektive për të paraqitur dokumente të vitit 2006 dhe që kësajsoj nuk mund të përjashtohet apriori një kontribut i tij në ndihmë të prindërve – për blerjen e një pasurie që në të ardhmen edhe ai (vëllai) do të përfitojë pjesën takuese nëpërmjet trashëgimisë, sikurse edhe vetë subjekti) – kjo vlerë në vetvete nuk mund të përbënte shkak (të vetëm) për aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe për analogji as nuk mund të konsiderohet si një shkak i mjaftueshëm për të justifikuar e legjitimuar përfundimin e Komisionit se për të evituar verifikimin dhe konstatimin e vetëm kësaj pamundësie financiare, (rreth 1,4 milionë lekë) subjekti ka kryer fshehjen e pasurisë në fjalë (*non expedit*).

1.4 Në këto kushte, kuadri faktiko-ligjor i lartpërshkruar, i gërshetuar me dinamikën e marrëdhënieve të posaçme në sferën e së njëjtës familje – anëtarët e së cilës, veç subjektit, nuk kanë qenë subjekte deklaruese ndër vite – paraqit një panoramë që nuk krijon bindjen që

kemi të bëjmë me një fshehje pasurie. Për rrjedhojë, çmoj se subjekti i rivlerësimit gjendet vetëm në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, por jo të shkronjës “c” dhe/ose “ç” të kësaj dispozite, dhe as të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës (*a fortiori*).

2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, gjithashtu nuk jam dakord (pjesërisht) me sa është konkluduar në pikat 38, 39 dhe 44 të këtij vendimi, (përfshi edhe përfundimin) si në vijim:

38. Në këto rrethana, duke marrë në konsideratë: (i) njohjen familjare dhe shoqërore të subjektit të rivlerësimit me shtetasin Th. B., që nënkupton pjesëmarrje reciproke në ngjarje me rëndësi; (ii) faktin që banojnë në të njëjtin qytet, me përmasa gjeografike të vogla dhe me popullsi pothuajse homogjene; (iii) natyrën e detyrës që ushtron subjekti i rivlerësimit – Komisioni krijoi bindjen se qëndrimi i subjektit për ta kanalizuar dijeninë nën lidhjen e krushqisë për shkak të bashkëshortes përbën në thelb një përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të fshehur marrëdhënien me këtë shtetas, në kuptim të nenit DH, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës.

39. Sa më sipër, Komisioni çmon se padijenja e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit është jobindëse e, për pasojë, nuk gjen zbatim rrethana lehtësuese e parashikuar në shkronjën “c” të pikës 5 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

44. Në përfundim, trupi gjykues, për sa u arsyetua më lart, vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “ç” të pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me kontrollin e figurës në formularin sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, duke fshehur kontaktin me shtetasin Th. B. si person i përfshirë në krimin e organizuar, referuar pikës 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur në kushtet e pikave 2 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Përfundimet e Komisionit lidhur me kontrollin e figurës (në faqen 57 të vendimit)

Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të figurës, arrin në këto përfundime:

i. Subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “ç” të pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar saktësisht, plotësisht dhe me vërtetësi formularin për kontrollin e figurës dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm pasi nuk ka deklaruar kontaktin e papërshtatshëm që është konstatuar nga prova të besueshme, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “a” të pikës 6 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016 [...].

2.1 Lidhur me sa më sipër, ndonëse bie dakord për ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm, me pasojat përkatëse, nuk ndaj të njëjtin mendim për sa i përket konkluzionit se: “[...] subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar saktësisht, plotësisht dhe me vërtetësi formularin për kontrollin e figurës dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm pasi nuk ka deklaruar kontaktin e papërshtatshëm [...]”. Kjo pasi, edhe pse rezulton i provuar kontakti i papërshtatshëm, në rastin konkret nuk mund të pohohet e njëjta gjë për sa i përket dijenisë së subjektit lidhur me hetimin e kryer ndaj personit të papërshtatshëm. Vetëm nëse kjo rrethanë

përcaktuese do të rezultonte e provuar, (*condicio sine qua non*), atëherë do të mund të aplikohet edhe pika 4 e nenit DH të Aneksit të Kushtetutës.

2.2 Në vlerësimin tim, në stadin në të cilin gjenden aktet, bazuar në materialin e administruar nga Komisioni apo të njohur nga trupa, nuk rezulton e provuar dijenia e subjektit, por ajo prezumohet, nisur nga disa rrethana, të cilat edhe pse mund të bëjnë që të ngrihen dyshime, gjithsesi, në këndvështrimin tim fakti kyç i dijenisë (*ipso facto*) nuk është provuar dhe, kështu, ky fakt nuk mund të merret i mirëqenë kinse përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në këto kushte, aplikimi i pikës 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës do të rezultonte disproporcional, jo në harmoni me faktet e provuara e në raport me dispozitat përkatëse, duke pasqyruar një penalizim (shtesë) të bazuar mbi prezumime rrethimore, ndonëse mbi dyshime të natyrshme. Për më tepër që do të mjaftonte vetëm aplikimi i pikës 3 i dispozitës së sipërcituar, i cili bazohet mbi fakte të provuara për të realizuar kështu qëllimin e ligjit, pa u zhytur në rrethana prezumimi, të cilat prodhojnë konkluzione të cënueshme, e që gjithsesi nuk e ndryshojnë vendimmarrjen lidhur me këtë kriter, por veçse dyfishojnë aplikimin e bazës ligjore ndëshkuese, (*dura lex sed lex*).

Lulzim HAMITAJ
Anëtar i trupit gjykues